

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ADJ Consulting Company” SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 05.06.2018, une, e nenshkruara:

1. **ANTONIA TIMO**, lindur ne Tirane, e datëlindjes 18.09.1964, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti G45918046G

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

**“ADJ Consulting Company” SHPK**

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

**Neni 2: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë:

**Lagjja 12, Rruga Vasil Kuqi, Numri pasurise 12/654, Godina nr. 2, Durrës.**

Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

**Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Shërbime dhe programime kompjuterike.
- Zhvillimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e teknologjisë së informacionit, të networkut dhe gjithçkaje që ka të bëjë me botën e informatikës dhe internetit; për këtë qëllim shoqëria mund të procedojë me ofrimin e aksesit në internet, me ofrimin e shërbimeve të housing e hosting, intranet, extranet, community, zhvillim software dhe aplikime multimediale.
- Realizimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web, realizimin dhe regjistrimin e domeineve, mbledhjen, ndermjetesimin, shitjen dhe publikimin e hapësirave publicitare on-line (bannering), realizimin e shërbimeve të grafikes publicitare dhe, në përgjithësi, të gjithçkaje që ka lidhje me kurimin e koordinuar të imazhit nga sipërmarrjet.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04-08).

### **Neni 5: Kapitali**

#### **Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

Kapitali i shoqërisë është **10.000(dhjetemije)** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**ANTONIA TIMO** është zotëruar i 1 kuote, me 100 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 10.000 leke.

### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. **ANTONIA TIMO** për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

**ANTONIA TIMO**

